



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Departamenti i Industrisë - Divizioni për Politika Industriale

SEKTORI C

Industria Përpunuese

R
A
P
O
R
T

2
0
2
2



Përmbajtja

Lista e shkurtesave	4
Lista e tabelave.....	5
Lista e figurave.....	6
Hyrje.....	7
Metodologjia.....	8
ANALIZA EKONOMIKE	9
Bruto produkti vendor	9
Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV.....	11
Vlera e shtuar për kokë banori.....	11
Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV sipas sektorëve	12
Investimet e huaja direkte	13
Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik.....	13
Investimet e huaja direkte sipas shteteve	14
Tregu financiar.....	15
Kreditë e brendshme nga bankat për sektorin privat (% e BPV-së)	15
Bilanci tregtar	16
Pjesëmarrja e eksporteve në (% e BPV)	16
Eksportet dhe importet, Sektori C.....	17
Eksportet, Sektori C.....	17
Importet, Sektori C	18
Eksportet dhe importet me vendet e BE-së.....	21
Eksportet me vendet e BE-së	23
Importet me vendet e BE-së	24
Eksportet dhe importet me vendet e CEFTA-së	25
Eksportet me vendet e CEFTA-së	27
Importet me vendet e CEFTA-së	28
Eksportet dhe importet me vendet e EFTA-së.....	29
Eksportet me vendet e EFTA-së	31
Importet me vendet e EFTA-së.....	31
Eksportet dhe importet me vendet e tjera	32
Eksportet me vendet e tjera.....	34
Importet me vendet e tjera	34
Diversiteti gjeografik i eksporteve dhe importeve.....	35

ANALIZA SOCIALE	36
Fuqia punëtore	36
Pjesëmarrja e sektorit C në punësim..	36
Kontributi i nën sektorëve në punësimin e përgjithshëm të Sektorit-C.....	38
Gratë të punësuar në sektorin C	39
Elasticiteti i punësimit	39
Pagat në prodhim.....	40
Intensiteti relativ i pagave në industrializim	41
Totali i pagave në sektorin-C, në raport me VShP.....	42
 ANALIZA MJEDISORE	 43
Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit.....	43
Intensiteti i energjisë në prodhim.....	43
Emetimet e CO2.....	44
Intensiteti i CO2 për vlerën e shtuar në Prodhim.....	45
 KONKLuzionET.....	 46
REFERENCAT.....	48

Lista e shkurtesave

ASK	-	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ATK	-	Administrata Tatimore e Kosovës
BE	-	Bashkimi Evropian
BKK	-	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
BPV	-	Bruto Prodhimi Vendor
BQK	-	Banka Qendrore e Kosovës
CEFTA	-	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore
DI	-	Departamenti i Industrisë
DK	-	Dogana e Kosovës
DPI	-	Divizioni për Zhvillimin e Politikave Industriale
EFTA	-	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
IHD	-	Investimet e Huaja Direkte
KTD	-	Korporata Tjera Depozituese
MINT	-	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NMVID	-	Norma Mesatare Vjetore e Interesit në Depozita
VShP	-	Vlera e Shtuar e Prodhimit
WITS	-	Zgjidhja e Tregtisë së Integruar Botërore
WDI	-	Treguesit e Zhvillimit Botëror

Lista e tabelave

Tabela 1	Bruto Produkti Vendor sipas sektorëve ekonomik.....	10
Tabela 2	IHD sipas sektorëve ekonomike, 2016 – 2022.....	13
Tabela 3	IHD sipas vendeve të origjinës, 2015 – 2022.....	14
Tabela 4	Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve.....	15
Tabela 5	Sektori-C, eksporti dhe importi me vendet e BE, CEFTA, EFTA dhe vendet tjera....	19
Tabela 6	Sektori-C, eksporti dhe importi me vendet e BE.....	21
Tabela 7	Sektori-C, eksporti dhe importi me vendet e CEFTA.....	25
Tabela 8	Sektori-C, eksporti dhe importi me vendet e EFTA	29
Tabela 9	Sektori-C, eksporti dhe importi me vendet tjera.....	32
Tabela 10	Sektori C, Numri i ndërmarrjeve dhe të punësuarve.....	37
Tabela 11	Elasticiteti i punësimit krahasuar me vendet tjera.....	40
Tabela 12	Pagat.....	41

Lista e figurave

Figura 1	Performanca e BPV-së/ kokë banori e Kosovës krahasuar me vendet e rajonit.....	9
Figura 2	Vlera e shtuar e sektorit prodhues pjesëmarrja në BPV.....	11
Figura 3	Vlera e Shtuar e Prodhimit për kokë banori në BPV, Kosova krahasuar me vendet tjera...	12
Figura 4	Vlera e shtuar në BPV sipas sektorëve.....	12
Figura 5	Bilanci tregtar i Kosovës.....	16
Figura 6	Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV).....	16
Figura 7	Pjesëmarrja e prodhimit në tregjet e eksportit në vitin 2021.....	35
Figura 8	Pjesëmarrja e prodhimit në tregjet e importit në vitin 2021.....	35
Figura 9	Kontributi i nën sektorëve në punësimin e Sektorit-C, në %.....	38
Figura 10	Punësimi gjithëpërfshirës në % (sipas gjinisë).....	39
Figura 11	Intensiteti relativ i pagave të industrisë.....	41
Figura 12	Fatura e pagave në raport me vlerën e shtuar, VSHP shprehur në %.....	42
Figura 13	Efiçienca e energjisë në sektorin e prodhimit.....	43
Figura 14	Intensiteti i energjisë.....	44
Figura 15	Emetimet e CO ₂ , për 1 milion euro në VSHP.....	44
Figura 16	Intensiteti i CO ₂ për 1 milion euro në VSHP të gjeneruar.....	45

Hyrje

Historikisht, industrializimi i Kosovës ka filluar në vitin 1960 deri në fund të viteve 1980, me kompanitë kosovare duke u integruar në një zinxhir më të gjerë të vlerës industriale në ish-Jugosllavi. Prodhimtaria fitoi një terren në Kosovë përmes prodhimit, ndër të tjera, të pjesëve të automobilave, prodhimit të baterive dhe përpunimit të metaleve. Shpërbërja e ish-federatës jugosllave vazhdoi paralelisht me një periudhë të de-industrializimit të shpejtë. Në periudhën e pasluftës, Kosova përjetoi zhvillim të ulët industrial.

Zhvillimi dinamik i sektorit privat në ndërmarrje të vogla dhe të mesme (NVM), me theks të veçantë sektori i prodhimit si dhe nismat për privatizim janë hapat e parë të proceseve drejt zhvillimit të ekonomisë së tregut dhe integritimeve në institucionet rajonale dhe ndërkombëtare. Në ekonominë e Kosovës ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë shtyllën kryesore të ekonomisë, me rreth 98%.

Ndoshta më shumë se shumica e sektorëve, prodhimi ka një potencial të lartë për të krijuar produktivitet të konsiderueshëm dhe fitime shtesë në vlerë duke tërhequr teknologjitë e reja dhe inovacionin. Zhvillimi industrial mund të ketë gjithashtu implikime të shumta pozitive zhvillimore përtej sektorit të prodhimit. Për shkak të lidhjeve të ndryshme me sektorët e tjerë të ekonomisë, zhvillimi industrial mund të stimulojë rritjen dhe zhvillimin në sektorë të tillë si bujqësia dhe minierat në Kosovë dhe në industritë e shërbimeve përkatëse.

Për të pasur një pasqyrë të detajuar të gjendjes apo trendëve të zhvillimit të industrisë, Hartuesit e Politikave Industriale në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, bazuar në të dhënat e përpunuara statistikore kanë përgatitur Raportin vjetor të Industrisë Përpunuese 2023, për analizën e performancës së sektorit-C, duke analizuar tre dimensionet kryesore: dimensionin ekonomik, social dhe mjedisor.

Qëllimi i hartimit të Raportit Vjetor është paraqitja e trendëve kryesore të zhvillimit të ekonomisë së Kosovës, për vitet 2020-2022, me theks të veçantë në degët kryesore industriale gjatë vitit 2022, por edhe një analizë krahasuese me vendet e rajonit, si dhe trendi i zhvillimeve në sektorët e industrisë përpunuese.

Të dhënat e analizuara, që janë paraqitur në këtë raport, mund t'iu shërbejë institucioneve, akademikëve, hartuesve të politikave, bizneseve operuese, (të tanishme dhe atyre me potencial në sektorin privat), investitorëve, donatorëve, hulumtuesve, etj. Raporti për Sektorin-C (industrinë përpunuese) ofron një pasqyrë më të hollësishme rreth trendëve kryesore me ndikim në industrinë e vendit si dhe lehtëson punën e të gjithë akterëve përkatës në hartimin e politikave zhvillimore më të efektshme, bazuar në indikatorë të matshëm.

Metodologjia

Raporti është hartuar duke përdorur metodat kërkimore të raporteve të ndryshme hulumtuese si dhe të dhënave sasiore dhe cilësore të pranuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, treguesit e bankës botërore dhe institucionet tjera relevante.

Të dhënat sasiore dhe cilësore, janë përpunuar dhe analizuar nga stafi i MINT-it konkretisht nga përpunuesit e të dhënave statistikore dhe hartuesit e politikave industriale në Departamentin e Industrisë.

Me qëllim të ofrimit të informatave të sakta të paraqitura në format tabelore dhe figurative janë përdorur metodat e kombinimit dhe krahasimit për të dhënat e prezantuara.

Të dhënat statistikore janë përpunuar në pjesën e përgjithshme për Industrinë përpunuese të Sektorit-C, vlerat e përgjithshme që përfshinë kodet 10-33 duke krahasuar me vendet e Ballkanit Perëndimor (BP6). Përshkrimi i nën sektorëve, në këtë Raport është radhitur sipas kodeve, ashtu siç janë të radhitura në NACRev2.

Të dhënat për nën sektorët, përveç që janë përpunuar sipas kodeve dy shifror, siç janë të dhënat për eksportin dhe importin, janë paraqitur edhe sipas aktiviteteve të kodit tre shifror, ndërsa të dhënat për nën aktivitetet për Ndërmarrjet, Punësimin dhe Qarkullimin në Kosovë janë paraqitur sipas kodit katër shifror.

Nga të dhënat statistikore të përpunuara janë hartuar analiza për BPV, IHD, trendët e eksporteve dhe importeve në industrinë përpunuese si në rajon ashtu edhe me vendet tjera si dhe vlerën më të lartë të eksporteve të Kosovës sipas shteteve. Në këtë raport, analizat me të dhëna, sipas kodit katër shifror janë paraqitur edhe për numrin e të punësuarave në industri, numrin e ndërmarrjeve sipas madhësisë dhe vlerën e qarkullimit, sipas aktiviteteve.

Pas analizave të paraqitura lidhur me të dhënat e përgjithshme dhe trendët për industrinë përpunuese, Sektori-C, në këtë raport janë ofruar konkluzionet që kanë të bëjnë me gjendjen dhe trendët e prodhimit në industrinë përpunuese në Kosovë.

Për të gjitha të dhënat që janë përdorur në Raportin Analitik për industrinë përpunuese janë shënuar thirrjet apo burimi i informatave.

ANALIZA EKONOMIKE


Bruto produkti vendor

Bruto Produkti Vendor (BPV) është treguesi më i rëndësishëm ekonomik i llogarive kombëtare, i cili paraqet performancë ekonomike të një shteti në një periudhë të caktuar kohore.

Sipas statistikave të Llogarive Kombëtare “Bruto Produkti Vendor (BPV) 2008-2022), botuar në Shtator 2023, rritja reale e BPV në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021, ishte 5.22%.

Sipas të dhënave të “World Development Indicators”, në raport me Vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Statistikave të Llogarive Kombëtare të Kosovës (2008-2022), Kosova paraqet performancën më të ulët ekonomike të përgjithshme në BPV / kokë banori prej €5,037 për vitin 2022, që do të thotë se është nën mesataren e BP6 sa është €5,927. Pavarësisht mungesës, duke filluar nga një bazë e ulët, Kosova ishte duke u rritur me një ritëm më të shpejtë se sa homologët e saj rajonalë: shkalla e rritjes së BPV-së/kokë banori e Kosovës ishte prej 5.9% gjatë periudhës 2011-2022 ku tejkaloi rajonin me (0.8%), me përjashtim të Bosnjës e Hercegovinës e cila kishte rritje për 6%, ndërsa mesatarja e BP6 ishte 5.1%. Megjithatë, shkalla ekzistuese e rritjes duhet të përshpejtohet për të siguruar arritjen më të shpejtë të homologëve të saj rajonalë.

Figura 1: Performanca e BPV-së/ kokë banori e Kosovës krahasuar me vendet e rajonit



Burimi: WDI dhe ASK

Aktivitetet ekonomike kryesore të cilat kanë kontribuar në rritjen e BPV në periudhën 2019-2022 ishin: Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave, industria përpunuese, ndërtimtaria, bujqësia, gjetia, pylltaria, peshkimi, afarizmi me pasuri të patundshme, etj.

Tabela 1. Bruto Produkti Vendor sipas aktiviteteve ekonomike, me çmime aktuale (në %)

Nace Rev.2	Aktivitetet ekonomike	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
A	Bujqësia, gjuetia , pylltaria dhe peshkimi	6.5	7.2	7.4	6.9	7.4
B	Industria nxjerrëse	2.2	2.0	2.0	1.9	1.5
C	Industria përpunuese	13.1	12.9	13.4	12.9	13.2
D	Furnizimi me energji elektrike, me gaz	3.5	3.4	3.9	3.6	3.8
E	Furnizimi me ujë	0.7	0.7	0.6	0.6	0.6
F	Ndërtimtaria	8.4	8.2	7.7	8.5	8.5
G	Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	12.5	12.8	12.8	13.6	14.3
H	Transporti dhe magazinimi	4.5	4.4	3.9	4.3	4.4
I	Hotelet dhe restorantet	1.9	2.1	1.6	2.1	2.1
J	Informimi dhe komunikimi	1.9	1.9	2.0	1.9	2.0
K	Aktivitetet financiare dhe te sigurimit	3.6	3.9	4.1	3.7	3.9
L	Afarizmi me pasuri të patundshme	7.1	7.0	7.3	6.4	6.1
M	Aktivitetet profesional, shkencore dhe teknike	1.5	1.4	1.6	1.4	1.4
N	Aktivitetet administrative dhe mbështetëse	0.7	0.7	0.7	0.7	0.7
O	Administrimi publik dhe i mbrojtjes; sigurimi i detyrueshëm social	5.8	5.9	6.6	5.5	5.0
P	Edukimi	3.8	3.7	3.8	3.4	3.1
Q	Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	2.2	2.2	2.7	2.3	2.1
R	Art, zbavitje dhe rekreacion	0.4	0.2	0.2	0.2	0.2
S	Shërbime tjera	0.4	0.4	0.4	0.3	0.3
T	Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallra dhe shërbimet e pa diferencuara që prodhojnë aktivitetet e familjeve për përdorim vetanak	-	-	-	-	-
	BVSH me çmime bazë	80.6	80.8	82.6	80.2	80.4
	Tatimet në produkte	19.4	19.2	17.4	19.8	19.6
	Subvencionet ne produkte	-	-	-	-	-
	Bruto Produkti Vendor	100	100	100	100	100

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës / Statistikat Ekonomike dhe Llogaritë Kombëtare

Sipas tabelës nr.1, në vitin 2022, tregtia me shumicë dhe pakicë, riparimi i automjeteve dhe motoçikletave është aktiviteti ekonomik i cili kontribuon më së shumti në BPV, me 14.3% në totalin e vlerës së BPV, pastaj renditet Industria përpunuese me 13.2% e cila krahasuar me vitin 2021 ka rritje në pjesëmarrjen e BPV për 0.3%.

Spektori-C, Industria përpunuese në BPV merr pjesë me 13.2 %.


Nga gjithsej 20 aktivitetet e pasqyruara në tabelë, rritje kanë shënuar 7 aktivitete deri sa në vitin 2021 rritje kishin 5 aktivitete, ndër të cilat rritjen më të lartë në vitin 2022 e ka shënuar aktiviteti, Tregtia me shumicë dhe pakicë; riparimi i automjeteve dhe motoçikletave me nga 0.7% rritje.

Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV

Sistemi i Llogarive Kombëtare të Kombeve të Bashkuara kërkon që vlera e shtuar të vlerësohet ose me çmimet bazë (duke përjashtuar taksat neto mbi produktet) ose me çmimet e prodhimit (përfshirë taksat neto mbi produktet e paguara nga prodhuesit, por duke përjashtuar shitjet ose taksat mbi vlerën e shtuar). Të dy vlerësimet përjashtojnë tarifën e transportit që faturohen veçmas nga prodhuesit. BPV-ja totale matet me çmimet e blerësve. Vlera e shtuar nga industria zakonisht matet me çmimet bazë.

Në vitin 2022, niveli i industrializimit i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VShP në BPV, është (13.6%) e tejkalon mesataren e BP6 (10.8%), me përjashtim të Bosnjës e Hercegovinës me (14.9%).

Figura 2. Vlera e shtuar e sektorit prodhues në BPV¹



Burimi: World Development Indicators


Vlera e Shtuar për kokë banori

Vlera e shtuar për kokë banori tregon bazën e nivelit të industrializimit të një vendi të përshtatur për madhësinë e ekonomisë. Një nga përdorimet statistikore të VShP për kokë banori, është klasifikimi i grupeve të vendeve sipas fazës së zhvillimit industrial.

Kapaciteti prodhues i prodhimit i një vendi matet me vlerën e shtuar të gjeneruar në sektorin e prodhimit për kokë banori. Sipas kësaj, në vitin 2021 Kosova ishte në 507€/kokë banori, mbi mesataren e BP6 prej 499€/kokë banori. Më ulët se Serbia e cila VSHP e kishte 836€/kokë banori dhe Bosnjën e Hercegovinën me 622€/kokë banori.

¹ Të dhënat për vitin 2022 për Serbinë dhe Malin e Zi nuk janë publikuar, andaj janë marrë të dhënat nga viti 2021.

Figura 3: Vlera e Shtuar e Prodhimit për kokë banori në BPV, Kosova krahasuar me vendet tjera




Burimi: WITS, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Pjesëmarrja e vlerës së shtuar në BPV sipas sektorëve

Për më tepër, ndërmjet viteve 2011 dhe 2021, Kosova ka shfaqur pak ndryshime strukturore në përbërjen e ekonomisë së saj. Për ekonominë e përgjithshme rëndësia e prodhimit është relativisht e kufizuar. Pjesa e vlerës së shtuar e prodhimit (VShP), si pjesë e BPV -së, mbeti e qëndrueshme, ndërsa në vitin 2021 shënoi rënie për 0.46%.

Pesha e vlerës së shtuar në shërbime përbënte mesatarisht 45%, ndërsa miniera duke e përfshi ndërtimtarin, përbënte mesatarisht 14% të BPV -së gjatë së njëjtës periudhë.

Figura 4. Vlera e shtuar në BPV sipas sektorëve



Burimi: WDI, përpunuar nga stafi i DI/DPI

Investimet e huaja direkte

Investimet e huaja direkte ndikojnë në rritjen e mundësive për integrim ekonomik duke krijuar lidhje të qëndrueshme dhe afatgjata në tregjet ndërkombëtare.

Kompanitë e mëdha botërore transferojnë kapitalin e tyre në ato vende që ofrojnë kushte më të mira në investime. Përveç taksave më të ulëta, fuqisë punëtore më të lirë dhe të kualifikuar, kompanitë janë të interesuara edhe për sundimin e rendit dhe ligjit në vendin e investimeve, por edhe për sigurimin e investimeve nga vendi përfitues.

Pjesëmarrja IHD-ve të prodhimit në totalin e IHD-ve për vitin 2022 ishte 1.84%.

Investimet e huaja direkte sipas aktivitetit ekonomik

Të dhënat e Bankës Qendrore të Kosovës tregojnë se në vitin 2022, hyrjet neto të IHD-ve në sektorin e prodhimit ishin 14.3 milion euro, deri sa në vitin 2021 kishin rënie për 0.4 milion euro. IHD në vitin 2020 ka pasur dalje neto ekuivalente me 1.3% të totalit të hyrjeve neto të IHD-ven në vitin 2021 dalja është ulur në 0.10% dhe në vitin 2022 kemi një trend pozitiv apo hyrje neto ekuivalente me pjesëmarrjen e industrisë përpunuese/prodhuese me 1.84% në totalin e IHD-ve. Pjesa më e madhe e IHD-ve është orientuar në sektorët e pasurive të paluajtshme dhe të ndërtimit që kanë tërhequr gati 67.37% të gjitha IHD-ve që rrjedhin në vend në dekadën e fundit, e që kanë pak efekt të përhapjes/shtrirjes (spillover effect).

Sa i përket investimeve, edhe pse Kosova ka pjesën më të madhe të formimit të kapitalit fiks bruto ndaj BPV-së në BP6, nuk është e mundur që të zërthehet shkalla deri në të cilën arrin kjo për shkak të investimeve në makineri dhe pajisje.

Tabela 2. IHD sipas sektorëve ekonomike, 2016 – 2022 (në milionë euro)

Sektorët	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
Bujqësia, pylltari dhe peshkatari	1.3	(1.3)	0.1	1.5	2.8	1.1	0.7
Xehetaria dhe guroret	(19.1)	(4.9)	(2.7)	(6.9)	29.1	1.4	52.4
Prodhimi	4.2	6.1	(17.7)	14.2	(4.6)	-0.4	14.3
Furnizimi me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar	(0.4)	(0.8)	12.1	13.5	30	(38.8)	44.3
Furnizimi me ujë, kanalizim, menaxhim mbeturinash	0.6	0.0	2.5	(0.6)	0.2	(0.5)	(0.2)
Ndërtimi	28.1	5.1	24.8	(17.1)	11.4	16.7	26.7
Tregti me shumicë dhe pakicë, riparim i mjeteve motorike, motoçikletave	14.0	9.0	19.6	(6.7)	(8.1)	(4.0)	15.1
Transport dhe ruajtje	0.9	(0.8)	(0.2)	(6.2)	(16.0)	4.3	(4.1)
Akomodim dhe aktivitete të shërbimeve me ushqim	0.8	1.1	1.8	1.4	1.1	0.7	(4.1)
Informacioni dhe Komunikimi	(4.2)	(3.8)	(9.6)	2.3	1.6	17.3	14.0
Aktivitete financiare dhe të sigurimit	19.0	55.2	15.5	13.9	85.1	24.6	53.9
Aktivitete të patundshmërive	139.7	154.7	205.2	223.8	201.1	384.0	523.7
Aktivitete profesionale shkencore dhe teknike	5.8	5.7	5.2	3.4	3.6	5.7	10.7
Aktivitete administrative dhe mbështetëse	21.9	23.7	4.7	3.7	0.8	1.4	10.7
Administratë publike dhe mbrojtje; siguri m social i detyrueshëm	1.9	1.3	0.9	1.7	1.1	1.1	1.5
Arsim	0.8	0.7	0.7	1.3	1.3	1.8	2.2
Shëndetësi njerëzor dhe aktivitete të punës sociale	1.3	(1.0)	(0.4)	0.6	0.3	2.7	1.2
Art, zbavitje dhe rekreacion	0.1	0.0	0.5	0.5	(0.1)	0.1	0.6
Aktivitete të shërbimeve tjera	3.9	3.7	7.2	2.8	1.7	(1.2)	1.2
Të pa klasifikuar	(0.3)	1.5	2.0	7.6	3.0	2.6	12.6

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës / <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/> qasur më 05.07.2023

Të dhënat tregojnë, se te aktiviteti ekonomik i ndërtimit nga një vlerë 16.7 milion euro, IHD shënuan rritje prej 10 milion euro apo është investuar 26.7 milion euro në vitin 2022, si dhe te sektori “Xehetaria dhe gurorët”, nga një vlerë negative 1.4 milion euro është investuar në 52.4 milion euro. Aktiviteti i cili ka kaluar nga vlera negative (38.8) milion euro në vlerë të investimeve me 44.3 milion euro në vitin 2022 është aktiviteti “Furnizimi me energji, gaz, avull dhe me ajër të kondicionuar”. Shikuar nga vlera investuese, sektori i cili ka shënuar vlerën më të lartë investive është aktiviteti i patundshmërisë me 523.7 milion euro.

Investimet e huaja direkte sipas shteteve

Investimet e Huaja Direkte (IHD) sipas shteteve, gjatë viteve 2015-2022, kanë një trend të qëndrueshëm të ngritjes së vlerës së IHD-ve. Vlera e përgjithshme e IHD-ve për vitin 2022 ishte 777.9 milion euro deri sa në vitin 2021 ishte 420.4 milion euro, që do të thotë se ka pasur rritje për 85%.

Tabela 3. IHD sipas vendeve të origjinës, 2015 – 2022 (në milion euro)

Shtetet		Vitet							
		2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
AT	Austria	33.5	9.9	20.3	11.2	11.9	27.6	22.9	44.7
DE	Gjermania	45.3	25.7	55.9	60.3	70.2	67.5	121.9	194.2
SI	Sllovenia	5.6	-4.5	1.2	-8.7	6.1	8.1	5.8	21.2
GB	Britania e Madhe	26.6	13.6	27.0	57.4	0.8	21.4	0.1	-3.4
CH	Zvicra	72.9	61.8	50.6	71.0	61.9	64.1	99.2	155.2
TR	Turqia	55.4	42.7	29.5	12.2	-31.9	14.6	-38	39.0
NL	Holanda	-36.4	-23.1	-14.1	-39.7	1.9	0.1	7.6	43.7
AL	Shqipëria	40.1	28.6	2.4	22.3	15.2	39.8	50.4	79.8
LU	Luksemburgu	0.1	0.6	2.1	1.9	1.3	-2.7	-3.6	1.8
RS	Serbia	0.8	-0.6	-1.4	0.4	0.4	6.0	5.0	-0.7
US	Shtetet e Bashkuara	25.0	23.0	20.3	35.5	22.8	29.6	63.7	93.0
FR	Franca	3.2	2.8	3.6	5.6	3.4	3.7	10.2	9.9
BG	Bullgaria	1.6	0.4	0.5	2.1	1.0	0.9	-0.8	1.4
MK	Maqedonia	0.1	3.2	-1.0	1.3	2.0	1.8	1.8	2.0
BA	Bosnja dhe Hercegovina	0.8	1.2	0.7	0.4	0.1	0.1	0.4	0.3
HR	Kroacia	0.1	-1.7	0.7	-1.0	0.9	-1.2	3.0	1.5
MT	Malta	0.1	0.1	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.8
CY	Qipro	0.1	0.4	0.8	1.3	2.9	0.9	0.9	1.7
SK	Sllovakia	0.1	0.8	0.1	0.5	1.4	0.3	0.3	0.2
CA	Kanadaja	1.1	2.5	3.0	3.2	5.3	4.7	8.8	17.8
CZ	Çekia	1.3	0.2	0.7	1.5	0.4	0.5	1.0	0.7
AE	Emiratet e Bashkuara Arabe	1.4	3.6	13.4	-2.5	3.8	2.8	0.6	4.5
NO	Norvegjia	2.9	3.4	3.5	5.1	4.9	3.2	7.7	7.0
KW	Kuvajti	0.0	0.2	0.0	-1.1	0.7	0.1	-0.5	-0.1
ES	Spanja	-0.8	0.2	2.5	0.3	0.7	0.0	0.3	0.1
EG	Egjipti	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
IT	Italia	5.7	1.9	7.0	2.7	7.9	3.5	8.5	10.4
GR	Greqia	-0.2	-0.4	-1.2	-0.3	0.1	-0.1	-1.1	-0.1
HU	Hungaria	0.3	0.6	0.4	0.1	19.1	26.1	3.6	14.3
Tjera	Tjera	22.1	22.8	26.9	29.1	39.6	22.3	40.7	37.0
Gjithsej		308.8	220.0	255.4	272.1	254.8	345.7	420.4	777.9

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/> qasur më 29.06.2023

Ndër vendet me investime më të larta të IHD-ve, për vitin 2022, është Gjermania, me investime prej 194.2 milion euro, me rritje për 59.34% krahasuar me vitin 2021. Zvicra për nga investimet radhitet e dyta, me 155.2 milion euro, me rritje për 56.45%, Shtetet e Bashkuara me 93 milion euro, me rritje për 46%, Shqipëria me 79.8 milion euro, me rritje për 58.3% etj.

Tregu financiar

Sa i përket normave efektive të interesit te korporatat tjera depozituese (KTD), marrë mesataren e normave të interesit për sektorët e pasqyruar në tabelën nr. 4, në vitin 2022, vërehet një rritje e lehtë e normës së interesit, krahasuar me vitin 2021.

Norma efektive e interesit në sektorin e industrisë është 6%.

Tabela 4. Normat efektive të interesit në kredi të KTD-ve

Sektorët	Norma e Interesit 2020	Norma e Interesit 2021	Norma e Interesit 2022
Kredi Konsumuese	6.8%	6.4%	6.3%
Kredi Hipotekare	5.7%	5%	4.9%
Bujqësore	9.3%	7.96%	8%
Industriale	6.0%	5.9%	6%
Shërbyese	6.0%	5.9%	6%
Sektorët Tjerë	6.3%	6.3%	6.5%

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, <https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/>

Tabela 4, pasqyron rritje të normave efektive të interesit në sektorin e industrisë, bujqësisë, shërbyese, sektorët tjerë, ndërsa rënie e lehtë vërehet në kreditë konsumuese dhe hipotekare.

Kreditë e brendshme nga bankat për sektorin privat (% e BPV-së)

Tregu financiar në Kosovë është mjaft dobët i zhvilluar për prodhuesit. Banka Botërore vlerëson se gati 70% e kompanive kosovare financojnë asetet fikse përmes burimeve të brendshme, me vetëm 11% që mbështeten në financimin bankar. Kredia e brendshme e Kosovës për sektorin privat, si përqindje e BPV-së, është 51% (që është e njëjtë për mesataren e BP6) por është shumë nën mesataren e OECD (160%). Për më tepër, përqindja e kredisë në sektorin përpunues ndaj totalit të kredive tregtare përbënte vetëm 17.3% në vitin 2021.


Sipas raportit vjetor 2022 të Bankës Qendrore të Kosovës, në totalin e kredive, industria prodhuese renditet e dyta me pjesëmarrjen në kredi me 19.3%, pas tregtisë e cila dominon nga të gjithë sektorët tjerë me pjesëmarrje në totalin e kredive me 42.7%. Sektori i dytë me pjesëmarrjen më të lartë, sektori i prodhimit, shënoi rritje të lartë vjetore prej 29.4 përqind dhe rezultoi sektori me kontributin më të madh në rritjen e gjithsej kreditimit sipas sektorëve ekonomik.

Bilanci tregtar

Bilanci tregtar paraqet raportin ndërmjet importeve për periudhë njëvjeçare. Kosova, në vitin 2022, shprehur në vlera financiare, eksportoi 920 milionë euro, dhe 5.6 miliardë euro import. Raporti mes eksportit dhe importit është (1.4:1.6), ndërsa mbulueshmëria e importit me eksport për vitin 2022 është 16.3%. Krahasuar me vitin paraprak në vitin 2022, eksportet kanë shënuar rritje për 22%, ndërsa rritja në import është 20%.

Raporti mes eksportit dhe importit është (1.4 : 8.6).

Figura 5: Bilanci tregtar i Kosovës në Euro




Burimi: ASK-Statistikat e Tregtisë së Jashtme (STJ), Qershor 2023 (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV)

Pjesëmarrja e eksporteve në BPV krahasuar me vitin 2021 ka shënuar rritje në të gjitha vendet e Ballkanit perëndimor. Pjesëmarrje e eksporteve të Kosovës në përqindjen e BPV-së për vitin 2021 është 35%, për derisa pjesëmarrja e eksporteve në vendet e Ballkanit perëndimorë është me e lart për 11%.

Figura 6: Pjesëmarrja e eksporteve totale në (% e BPV), 2011-2021



Burimi: WDI, ASK (përpunuar nga DI/DPI-së)

Sipas figurës 6. Maqedonia e Veriut ka pjesëmarrjen me të larte të eksporteve në BPV me 66%, krahasuar me vendet e Ballkanit perëndimorë.

1. Eksporti dhe importi me vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe vendet tjera, për Sektorin – C (Industria përpunuese)

Treguesi i numrit të ndërmarrjeve eksportuese, sipas nën sektorëve të industrisë përpunuese, tregon pjesëmarrjen e ndërmarrjeve në eksport. Sipas OECD-së. Më pak se 10% e ndërmarrjeve janë eksportuese në të gjitha vendet².

Në industrinë përpunuese, raporti mes eksportit dhe importit në vitin 2022 është (1.3 : 1.7), ndërsa mbulueshmëria e importit me eksport është 14.6%.

Nga gjithsej 5,984 ndërmarrje në kuadër të Sektorit-C, 1333 apo 22% janë ndërmarrje eksportuese.

Sektor-C, në eksportin e përgjithshëm merr pjesë me 82.9%

Të dhënat në tabelën nr.5, paraqesin një pasqyrim të vlerave të eksportit dhe importit me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe me vendet e tjera, për nën sektorët e Sektorit-C, për vitet 2019-2021.

• Eksportet, Sektori - C

Vlera e përgjithshme e eksporteve, për vitin 2021, në vendet e BE-së , CEFTA-së , EFTA-së dhe vendet tjera, ishte 755.72 milion euro, ndërsa sektori i industrisë përpunuese ka marrë pjesë me vlerë prej 626.34 milion euro, apo rreth 84%, në kuadër të eksportit të përgjithshëm.

Të dhënat në tabelën nr. 8, tregojnë se rritja e eksporteve të Sektorit-C, për vitin 2021, është më e lartë për 57%, krahasuar me vitet paraprake, pasi që rritja e eksporteve në vitin 2020 krahasuar me vitin 2019 ishte 36.6%.

Eksportet gjatë vitit 2021, në Sektorin-C, dominohen nga nën sektori “Prodhimi i mobileve” me 22% dhe me rritje për 317%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e mobileve kryesisht janë eksportuar në SHBA me 77%, në Zvicër me 8% etj.

Në vendin e dytë, me pjesëmarrje në eksport, radhitet nën sektori “Prodhimi i metaleve”, me pjesëmarrje prej 21%, ndërsa krahasuar me vitin 2020, ky nën sektor, ka pasur rritje për 17%. Vendet me të cilat është realizuar më së tepërmi eksporti nga ky nën sektor janë: në Itali me 32%, në Shqipëri me 18%, në Maqedoninë e Veriut me 15% etj.

Në vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve të plastikës dhe gomës” me pjesëmarrje prej 12%, në kuadër të Sektorit-C, ndërsa ky nën sektor ka shënuar rritje për 34%, krahasuar me vitin 2020. Prodhimet e këtij nën sektori kryesisht janë eksportuar në Gjermani

² Exports by enterprise size class - OECD i Library / https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/entrepreneur_aag-2013-11-en.pdf?

me 21%, në Zvicër me 14%, në Holandë me 12%, në Maqedoni dhe Shqipëri me nga 7%, në Serbi me 6.7% etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike”, ka pjesëmarrje në eksport me 8.4% dhe me rritje të theksuar prej 66%, krahasuar me vitin 2020. Eksporti i këtyre produkteve kryesisht është realizuar në Kazakistan me 18%, Zvicër dhe Gjermani me nga 15%, në Maqedoninë e Veriut me 9%, në Shqipëri me 7% etj.

Në kuadër të nën sektorëve, i pestë me radhë, në eksporte është nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 7%, i cili në vitin 2021 ka shënuar rritje për 33%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet ushqimore janë eksportuar në Shqipëri për 17%, në Serbi me 14%, Maqedoninë e Veriut me 11%, në Gjermani për 10% etj.

Nën sektori “Prodhimi i pijeve”, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë me 6% dhe me rritje në eksport prej 24%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet e pijeve me se shumti janë eksportuar në Shqipëri me 46%, në Maqedoninë e Veriut me 17% etj.

• Importet, Sektori-C

Totali i importeve në Kosovë, nga vendet e BE-së, CEFTA-së, EFTA-së dhe nga vendet tjera, për vitin 2021, është 4.684 miliard euro, ndërsa Sektori-C ka marrë pjesë me vlerë prej 4.338 miliard euro, apo rreth 92.63%.

Sektori-C, në importin e përgjithshëm merr pjesë me 92.63%.

Importet gjatë vitit 2021, në Sektorin-C, dominohen nga nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” me 13.4% edhe pse krahasuar me vitin 2020, ky nën sektor ka pasur rritje të konsiderueshme për 24.5%. Këto produkte janë importuar nga Serbia për 10.5%, nga Italia me 8.74%, nga Maqedonia e Veriut me 7.89%, nga Turqia me 7.75%, nga Polonia 6.25% etj.

Në vendin e dytë radhitet nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, me pjesëmarrje prej 10% në importe të Sektorit-C dhe me rritje për 73.4%, nga viti paraprak. Këto produkte janë importuar me se shumti nga Greqia për 30%, nga Arabia Saudite për 14%, nga Italia për 12%, nga Maqedonia e Veriut për 11%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio”, radhitet në vendin e tretë në import, me pjesëmarrje prej 9% dhe ka shënuar rritje për 45%, krahasuar me vitin 2020. Produktet e këtyre mjeteve motorike me se shumti janë importuar nga Gjermania për 72% etj.

Në vendin e katërt radhitet nën sektori “Prodhimi i Metaleve”, me pjesëmarrje në Sektorin-C me 8.7% dhe me rritje për 57%, nga viti paraprak. Këto produkte janë importuar nga Shqipëria për 35%, nga Maqedonia e Veriut për 10%, nga Ukraina për 8%, nga Italia për 6.5% etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike”, në vitin 2021, në kuadër të Sektorit-C, merr pjesë me 8.5% dhe ka shënuar rritje për 43% krahasuar me vitin 2020. Këto produkte janë importuar nga Gjermania për 13.5%, nga Turqia për 13%, nga Kina për 9%, nga Franca 6% etj.

Tabela 5. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së, EFTA-së, BE-së dhe Vendet tjera 2019– 2021

Kodi	Industria Përpunues, Sektori-C	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2019	2020	2021	Ndryshimi (2021>2020)	Ndryshimi ne % (2021>2020)	2019	2020	2021	Ndryshimi (2021>2020)	Ndryshimi ne% (2021>2020)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	28,424,151.36	33,402,372.88	44,439,203.38	11,036,830.50	33.04	459,196,871.23	466,609,046.82	580,982,202.06	114,373,155.24	24.51
11	Prodhi i pijeve	28,665,800.23	29,666,793.39	36,884,711.45	7,217,918.06	24.33	82,588,664.30	77,586,544.73	116,576,207.92	38,989,663.19	50.25
12	Prodhi i produkteve të duhanit	-	-	32,000.00	-	-	68,512,606.49	63,009,976.51	87,226,753.91	24,216,777.40	38.43
13	Prodhi i Tekstilit	7,875,908.03	17,948,552.17	22,623,419.15	4,674,866.98	26.05	56,796,552.95	66,662,771.63	100,387,677.75	33,724,906.12	50.59
14	Prodhi i veshjeve	3,293,023.19	5,156,424.34	10,271,312.07	5,114,887.73	99.19	118,008,278.57	98,738,284.03	142,516,943.74	43,778,659.71	44.34
15	Prodhi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	3,080,819.54	2,335,812.77	3,321,006.18	985,193.41	42.18	49,380,964.63	38,212,879.80	50,096,010.97	11,883,131.17	31.10
16	Prodhi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	7,677,012.54	10,409,819.21	14,021,312.71	3,611,494.50	34.69	75,584,593.05	68,913,586.17	98,133,723.16	29,220,136.99	42.40
17	Prodhi i letërës dhe produkteve prej letërës	2,039,439.64	2,893,870.02	3,979,310.25	1,085,440.23	37.51	61,938,776.04	58,771,929.99	76,575,084.54	17,803,154.55	30.29
18	Shtypja dhe riprodhi i mediave të incizuara	-	-	-	-	-	192,046.50	140,039.96	46,396.38	(93,643.58)	(66.87)
19	Prodhi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	2,655,565.82	1,428,173.61	3,527,500.88	2,099,327.27	146.99	395,650,224.84	246,979,760.45	428,218,367.37	181,238,606.92	73.38
20	Prodhi i produkteve kimike	8,160,771.92	19,634,905.19	21,841,644.32	2,206,739.13	11.24	237,989,157.53	257,101,389.35	367,679,412.89	110,578,023.54	43.01

21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	931,976.93	735,067.86	792,946.65	57,878.79	7.87	69,624,461.97	93,239,025.99	114,344,154.47	21,105,128.48	22.64
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	51,494,994.46	58,284,613.04	78,539,277.51	20,254,664.47	34.75	155,217,193.08	151,630,341.62	205,173,799.06	53,543,457.44	35.31
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	7,592,128.25	9,613,701.30	18,715,704.11	9,102,002.81	94.68	167,647,853.52	171,245,487.79	225,268,230.22	54,022,742.43	31.55
24	Prodhimi i Metaleve	75,872,939.29	112,420,890.58	131,693,061.35	19,272,170.77	17.14	264,476,551.92	241,185,291.40	378,882,849.22	137,697,557.82	57.09
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	23,451,261.04	31,730,428.78	52,724,138.82	20,993,710.04	66.16	112,031,510.36	124,107,528.74	150,806,844.07	26,699,315.33	21.51
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	5,318,945.82	8,256,502.33	11,425,043.55	3,168,541.22	38.38	108,667,847.51	108,189,194.60	152,991,201.85	44,802,007.25	41.41
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	4,180,545.40	3,768,112.38	5,580,052.30	1,811,939.92	48.09	148,011,315.93	151,215,298.70	189,308,975.86	38,093,677.16	25.19
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	8,057,317.86	9,424,222.44	15,165,124.02	5,740,901.58	60.92	217,871,513.60	206,678,136.71	306,918,216.18	100,240,079.47	48.50
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	2,924,958.97	4,086,495.42	6,167,183.79	2,080,688.37	50.92	299,743,201.02	268,176,636.63	389,833,231.61	121,656,594.98	45.36
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	87,518.23	106,339.81	136,498.63	30,158.82	28.36	8,368,461.37	15,983,817.52	54,965,924.63	38,982,107.11	243.88
31	Prodhimi i mobileve	15,316,687.30	33,561,425.11	139,977,652.84	106,416,227.73	317.08	49,691,848.08	38,988,969.43	61,399,762.64	22,410,793.21	57.48
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	4,599,984.53	3,596,557.03	4,483,504.59	886,947.56	24.66	46,106,308.49	47,986,428.74	60,462,523.65	12,476,094.91	26.00
	Gjithsej	291,701,750.35	398,461,079.66	626,341,608.55	227,880,528.89	57.19	3,253,296,802.98	3,061,352,367.31	4,338,794,494.15	1,277,442,126.84	30.29

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

2.1. Eksporti dhe importi me vendet e BE-së, përfshirë Mbreterinë e Bashkuar

Eksportet me vendet e BE-së, për vitin 2021, janë në vlerë prej 214.7 milion euro, që do të thotë se kanë shënuar rritje për 48.97%, ndërsa vlera e importit është 1.936 miliard euro dhe paraqet rritje në importe për rreth 37%, krahasuar me vitin 2020.

Bazuar në tabelën nr. 9, në totalin e shkëmbimeve tregtare për vitin 2021, Kosovë – BE, Mbreterinë e Bashkuar eksporti merr pjesë me 11%, ndërsa importi me 89% mund të themi se kemi një trend në rritje të eksporteve, krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 6. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e BE-së, përfshirë Mbreterinë e Bashkuar për vitin 2019– 2021

Kodi	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2019	2020	2021	Ndryshimi (2021>2020)	Ndryshimi (2021>2020)	2019	2020	2021	Ndryshimi (2021>2020)	Ndryshimi në % (2021>2020)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	10,200,710.55	13,178,958.60	17,179,830.50	4,000,871.90	30.36	270,298,066.20	261,901,243.38	308,563,207.74	46,661,964.36	17.82
11	Prodhimi i pijeve	5,473,128.63	6,456,618.94	8,788,137.63	2,331,518.69	36.11	55,107,797.10	40,596,444.54	47,128,736.73	6,532,292.19	16.09
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-	-	-	49,255,240.41	46,168,805.65	61,876,079.98	15,707,274.33	34.02
13	Prodhimi i Tekstilit	3,788,717.63	3,840,869.08	6,621,300.33	2,780,431.25	72.39	7,929,205.65	7,127,854.00	8,322,175.58	1,194,321.58	16.76
14	Prodhimi i veshjeve	2,042,388.01	1,890,517.46	2,270,618.94	380,101.48	20.11	7,432,895.22	5,676,436.48	7,355,443.44	1,679,006.96	29.58
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	2,570,831.25	1,442,825.65	2,284,910.39	842,084.74	58.36	4,252,600.02	3,238,301.52	4,513,662.97	1,275,361.45	39.38
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	3,112,584.10	4,743,204.51	5,602,674.06	859,469.55	18.12	38,620,394.41	30,195,842.71	41,126,446.57	10,930,603.86	36.20

17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	192,086.18	590,510.97	983,641.10	393,130.13	66.57	34,051,389.79	27,748,346.19	31,268,884.43	3,520,538.24	12.69
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-	-	-	47,165.52	21,713.70	15,709.20	(6,004.50)	(27.65)
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	535.05	45,994.86	53,090.28	7,095.42	15.43	205,572,380.02	135,657,078.52	204,390,317.26	68,733,238.74	50.67
20	Prodhimi i produkteve kimike	3,137,342.94	10,259,254.03	11,095,702.02	836,447.99	8.15	139,793,906.33	140,242,511.42	197,631,933.27	57,389,421.85	40.92
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	17,520.00	-	188,217.30	-	-	47,944,225.47	57,724,657.19	72,364,412.75	14,639,755.56	25.36
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	25,466,885.43	28,403,227.43	43,512,318.02	15,109,090.59	53.19	81,664,634.12	73,875,700.18	102,356,952.76	28,481,252.58	38.55
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	1,834,013.95	2,290,815.98	5,087,419.34	2,796,603.36	122.08	60,825,685.50	51,408,920.13	75,867,923.83	24,459,003.70	47.58
24	Prodhimi i Metaleve	20,690,712.12	36,720,531.68	60,598,720.23	23,878,188.55	65.03	59,298,364.72	46,357,191.42	69,573,854.37	23,216,662.95	50.08
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	9,464,910.03	15,629,796.69	22,124,098.14	6,494,301.45	41.55	52,897,096.94	51,310,860.99	60,002,250.16	8,691,389.17	16.94
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	2,287,040.96	3,291,252.08	5,301,162.67	2,009,910.59	61.07	28,988,870.78	25,053,553.88	30,385,260.62	5,331,706.74	21.28
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	869,658.06	888,130.18	1,445,195.53	557,065.35	62.72	53,098,346.80	48,787,559.90	61,554,973.30	12,767,413.40	26.17
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	2,944,540.30	3,833,599.99	6,308,983.77	2,475,383.78	64.57	112,081,734.77	99,365,153.16	166,765,317.33	67,400,164.17	67.83
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysme rimorkio	1,329,593.58	1,219,522.33	3,152,393.75	1,932,871.42	158.49	275,939,984.88	234,483,389.92	355,053,751.17	120,570,361.25	51.42
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	9,133.96	5,660.66	69,751.44	64,090.78	1132.21	2,003,524.33	2,078,898.90	4,398,768.87	2,319,869.97	111.59

31	Prodhimi i mobileve	5,518,831.18	6,863,507.74	9,132,559.59	2,269,051.85	33.06	11,603,778.03	7,456,528.64	10,879,403.78	3,422,875.14	45.90
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	3,519,163.57	2,579,009.15	2,970,800.84	391,791.69	15.19	14,667,964.57	15,902,511.31	15,139,025.31	(763,486.00)	(4.80)
	Gjithsej	104,470,327.48	144,173,808.01	214,771,525.87	70,597,717.86	48.97	1,613,375,251.58	1,412,379,503.73	1,936,534,491.42	524,154,987.69	37.11

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- Eksportet me vendet e BE, përfshirë Mbreterinë e Bashkuar**

Në vendin e parë, me pjesëmarrje në eksport me vendet e BE-së, radhitet nën sektori “Prodhimi i metaleve” me 28%, për derisa ka shënuar rritje të lartë në eksport për 65%, krahasuar me vitin 2020. Vendi në të cilin janë eksportuar më së shumti produktet e metaleve janë në Itali me 70%. Nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës”, merr pjesë me 20%, në totalin e eksporteve me vendet e BE-së, ndërsa krahasuar me vitin paraprak ka shënuar rritje për 53%. Ky eksport, kryesisht është realizuar në Gjermani me 38%, në Holandë me 22%, në Italia me 9%, etj.

Në vitin 2021, nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike” merr pjesë me 10%, ku ka shënuar rritje për 41.6% krahasuar me vitin paraprak. Eksportet e produkteve të fabrikuar metalike, destinimin e tregut e kanë në Gjermani me 36%, në Holandë me 17%, në Francë me 13%, etj.

Rritje të eksportit, në vendet e BE-së, në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, ka shënuar nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” për 30%. Në totalin e eksporteve të Sektorit-C, me vendet e BE-së, ky nën sektor merr pjesë me 8%. Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në Gjermani me 27%, në Itali me 18%, në Holandë 11% etj.

- **Importet me vendet e BE-së, përfshirë Mbreterinë e Bashkuar**

Nga të dhënat e paraqitura në Tabelën nr. 9 vërehet se nga 23 nën sektorë, vetëm 21 prej tyre kanë rritje në import me vendet e BE-së gjatë vitit 2021, përderisa rënie kanë shënuar 2 nën sektorët të Sektorit C.

Nën sektori “Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio”, në vitin 2021 në importin me vendet e BE-së, në kuadër të Sektorit C merr pjesë me 18% dhe ka shënuar rritje për 51%, produktet e mjeteve motorike janë importuar kryesisht nga Gjermania me 79% etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, merr pjesë në importe me 16% në kuadër të Sektorit C, por në vitin 2021 ka shënuar rritje në importe për 18% krahasuar me vitin 2020. Produktet ushqimore janë importuar nga Italia për 16%, nga Kroacia për 10%, nga Polonia për 12%, nga Sllovenia për 9%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, në kuadër të Sektorit-C, me pjesëmarrje në importe me vendet e BE-së, është 10%, me rritje për 51% në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak. Importi është realizuar kryesisht nga Greqia për 62% dhe nga Italia për 25%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve kimike” merr pjesë me 10% në totalin e importeve me vendet e BE-së, në kuadër të Sektorit C. Në vitin 2021, ka shënuar rritje në importe për 41%, krahasuar me vitin paraprak. Produktet kimike importohen nga Gjermania për 25%, nga Franca për 12%, nga Italia për 10.59%, nga Polonia për 9.2%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t” merr pjesë në importe të vendeve të BE-së me 8.6%, me rritje importi në 2021 prej 68% krahasuar me vitin paraprak. Importin më të lartë e ka realizuar nga Gjermania për 43.6% dhe nga Italia për 21%, nga Spanja për 12.7%, etj.

Pjesëmarrja në importe të nën sektorit “Prodhimi i produkteve të gomës dhe plastikës” është 5.2% dhe me rritje për 38.6% krahasuar me vitin 2020. Produktet e këtij nën sektori janë importuar nga Gjermania për 46%, nga Italia për 10%, nga Bullgaria për 9%, etj.

2.2. Eksporti dhe importi me vendet e CEFTA-së

Në Tabelën nr.10 janë pasqyruar vlerat e importit dhe eksportit me vendet e CEFTA-së për nën sektorët (10 deri 33) në kuadër të Sektorit-C.

Në përgjithësi, eksportet me vendet e CEFTA-së, në kuadër të Sektorit C, në vitin 2021, kanë shënuar rritje për 19%, ndërsa importi ka shënuar rritje për 45.5%.

Tabela 7. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e CEFTA-së për sektorët e industrisë, 2019 – 2021

Kodi	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti			Balanci		Importi			Balanci	
		2019	2020	2021	Ndryshimi (2021 > 2020)	Ndryshimi në % (2021 > 2020)	2019	2020	2021	Ndryshimi (2021 > 2020)	Ndryshimi në % (2021 > 2020)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	14,357,962.18	15,822,484.52	22,767,316.22	6,944,831.70	43.89	63,581,293.51	93,560,843.04	135,004,596.35	41,443,753.31	44.30
11	Prodhimi i pijeve	21,341,142.71	20,740,122.01	25,583,798.36	4,843,676.35	23.35	22,472,368.09	32,540,492.94	60,383,339.42	27,842,846.48	85.56
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	32,000.00			1,645,261.50	2,277,951.00	2,304,417.39	26,466.39	1.16
13	Prodhimi i Tekstilit	3,040,604.31	5,228,563.64	6,765,045.39	1,536,481.75	29.39	1,108,200.27	2,822,984.26	3,539,437.39	716,453.13	25.38
14	Prodhimi i veshjeve	517,408.79	488,449.48	701,680.57	213,231.09	43.65	511,477.99	1,132,013.28	1,860,176.61	728,163.33	64.31
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	500,696.70	877,298.80	991,476.72	114,177.92	13.01	719,700.93	1,222,866.53	1,485,880.59	263,014.06	21.51
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara-thurëse	1,879,859.73	1,744,933.42	3,217,748.30	1,472,814.88	84.41	15,500,859.88	19,325,981.97	26,047,554.60	6,721,572.63	34.78
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letërës	1,790,001.45	2,188,547.87	2,855,782.09	667,234.22	30.49	13,921,943.96	17,775,005.88	24,872,627.95	7,097,622.07	39.93
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-			-	-	-	-	

19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	2,655,010.77	1,382,178.75	3,474,410.60	2,092,231.85	151.37	70,576,780.70	33,593,347.96	80,178,589.36	46,585,241.40	138.67
20	Prodhimi i produkteve kimike	4,795,288.74	6,602,405.92	8,373,783.40	1,771,377.48	26.83	17,719,070.31	33,877,240.24	43,869,214.50	9,991,974.26	29.49
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	579,108.09	86,049.36	362,227.18	276,177.82	320.95	5,823,574.61	10,450,113.77	11,783,801.83	1,333,688.06	12.76
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	14,537,627.77	15,555,357.82	19,420,942.46	3,865,584.64	24.85	21463573.9	26,491,523.57	38,593,792.36	12,102,268.79	45.68
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	3,597,513.73	4,921,744.61	8,758,261.02	3,836,516.41	77.95	56,526,379.01	72,491,495.96	80,660,753.42	8,169,257.46	11.27
24	Prodhimi i Metaleve	21,059,759.26	66,234,411.33	63,720,210.12	-2,514,201.21	-3.80	134,771,893.14	136,655,869.68	201,607,539.75	64,951,670.07	47.53
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	7,218,038.23	9,224,505.71	11,356,341.40	2,131,835.69	23.11	8,159,565.03	18,128,793.07	23,641,801.82	9,969,228.04	30.41
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	1,932,229.50	3,201,790.63	3,955,946.95	754,156.32	23.55	49,994.83	230,590.18	523,521.50	292,931.32	127.04
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	2,108,626.08	1,498,768.21	2,185,450.47	686,682.26	45.82	12,778,039.02	19,164,292.92	24,509,876.26	6,386,253.90	27.89
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	3,495,179.99	3,957,021.33	5,412,952.68	1,455,931.35	36.79	3,163,047.99	8,038,065.30	11,286,908.01	4,875,017.31	40.42
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	810,090.04	1,538,426.36	1,242,990.34	(295,436.02)	(19.20)	344,331.00	634,105.24	398,200.90	(289,774.24)	(37.20)
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	43,530.78	47,315.01	51,976.97	4,661.96	9.85	8,487.17	165,502.77	223,385.13	157,015.60	34.97
31	Prodhimi i mobileve	3,282,665.87	4,387,380.58	6,086,720.15	1,699,339.57	38.73	6,715,247.71	7,349,145.23	11,146,903.75	3,797,758.52	51.68
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	775,137.63	786,967.29	1,010,302.56	223,335.27	28.38	133,691.20	1,065,362.68	818,945.86	(246,416.82)	(23.13)
	Gjithsej	110,317,482.35	166,514,722.65	198,327,363.95	31,812,641.30	19.11	457,694,781.75	538,993,587.47	784,741,264.75	245,747,677.28	45.59

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksporti me vendet e CEFTA-së**

Eksportet me vendet e CEFTA-së, në Sektorin-C, gjatë vitit 2021, dominohen nga nën sektori “Prodhimi i metaleve”, me pjesëmarrje për 32%. Në vitin 2021, ky nën sektor ka shënuar rënie në eksport për 4% krahasuar me vitin 2020. Vendet në të cilat janë eksportuar më së shumti produktet e metaleve janë: në Shqipëri me 38%, në Maqedoninë e Veriut me 30%, në Serbi me 24% etj.

Nën sektori “Prodhimi i pijeve” merr pjesë në eksporte me këto vende me 12.9%. Ky nën sektor ka shënuar rritje në eksport për 23% krahasuar me vitin 2020. Produktet e pijeve janë eksportuar kryesisht në Shqipëri me 66%, në Maqedoninë e Veriut me 24%, etj.

Pjesëmarrje në eksportet e Sektorit-C me vendet e CEFTA-së ka shënuar edhe nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” për 11.4%. Në vitin 2021 ky nën sektor ka shënuar rritje për 43.8% krahasuar me vitin paraprak.

Produktet e këtij nën sektori janë eksportuar në Shqipëri 33%, në Serbi 27% në Maqedoninë e Veriut 23% etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve nga goma dhe plastika”, në kuadër të Sektorit-C, në eksport merr pjesë me 10%. Ky nën sektor ka shënuar rritje në eksport për 24.85% krahasuar me vitin paraprak.

Vendet me të cilat janë eksportuar më së shumti produktet e gomës dhe plastikës janë në Shqipëri me 29%, në Maqedoninë e Veriut me 29.6%, dhe në Serbi 27%.

Rritje në eksporte për 13% ka shënuar nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë”, por me pjesëmarrje të ulët në Sektorin-C për vetëm 0.53%. Vendet ku janë eksportuar produktet e lëkurës janë në Shqipëri me 76.06%, në Mal të Zi me 5.54, etj.

- **Importi me vendet e CEFTA-së**

Importet e Kosovës me vendet e CEFTA-së, në vitin 2021, karakterizohen me rritje të theksuar të produkteve nga Sektori-C (Industria Përpunuese), në numrin më të madh të nën sektorëve. Në kuadër të nën sektorëve të Sektorit C, pjesëmarrjen më të lartë në importe me vendet e CEFTA-së e ka nën sektori “Prodhimi i metaleve” me 25.7%. Në vitin 2021, ky nën sektor ka shënuar rritje në import për 47.5% krahasuar me vitin 2020. Produktet e metaleve kryesisht janë importuar nga Shqipëria për 66%, nga Maqedonia e Veriut për 19%, etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore” merr pjesë në importe me vendet e CEFTA-së me 17%. Por në vitin 2021 ka shënuar rritje të importit për 44.3% krahasuar me vitin paraprak. Produktet ushqimore janë importuar nga Serbia për 45%, nga Maqedonia e Veriut për 34%, etj.

Në vendin e tretë radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve minerale jo metalike” me pjesëmarrje në importe për 10%. Në vitin 2021 ky nën sektor ka shënuar rritje në import për 11% krahasuar me vitin 2020. Produktet për këtë nën sektor janë importuar nga Shqipëria për 41%, nga Maqedonia e Veriut 40%, etj.

Rritje më të lartë në importet me vendet e CEFTA-së, në kuadër të Sektorit C, gjatë vitit 2021, ka shënuar nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës” mbi 100% krahasuar me vitin 2020. Produktet e koksit janë importuar nga Maqedonia e Veriut për 60%, nga Shqipëria për 18%, nga Serbia për 22%, etj.

2.3 Eksporti dhe Importi me vendet EFTA-së

Eksportet e Kosovës me shtetet anëtare të EFTA-së, për vitin 2021, kanë shënuar vlerën prej 50 milion euro, rritje prej 29%, përderisa importet kanë shënuar vlerën prej 34.6 milion euro, rritje për 39% krahasuar me vitin 2020.

Tabela 8. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e EFTA-së për sektorët e industrisë, 2019 - 2021

Kodi	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti		2021	Balanci		Importi			Balanci	
		2019	2020		Ndryshimi (2021>2020)	Ndryshimi në % (2021>2020)	2019	2020	2021	Ndryshimi (2021 >2020)	Ndryshimi në % (2021>2020)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	769,721.14	940,383.22	896,030.46	(44,352.76)	(4.72)	1,174,757.97	1,269,685.90	1,440,169.39	170,483.49	13.43
11	Prodhimi i pijeve	936,411.26	1,165,846.05	1,285,285.42	119,439.37	10.24	520,749.71	334,431.68	469,526.79	135,095.11	40.40
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-			9,304,367.00	4,924,526.54	7,225,952.56	2,301,426.02	46.73
13	Prodhimi i Tekstilit	81,883.57	474,158.46	359,836.12	(114,322.34)	(24.11)	119,480.66	110,129.59	108,644.07	(1,485.52)	(1.35)
14	Prodhimi i veshjeve	121,479.90	351,781.10	340,398.27	(11,382.83)	(3.24)	1,000,551.16	1,114,344.29	1,353,448.97	239,104.68	21.46
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	7,137.07	4,551.06	4,782.75	231.69	5.09	31,469.11	58,184.98	33,822.05	(24,362.93)	(41.87)
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilieve; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshtuara-thurëse	2,601,368.57	3,869,950.84	4,730,568.65	860,617.81	22.24	1,722,671.09	1,417,783.31	1,675,787.13	258,003.82	18.20
17	Prodhimi i letërës dhe produkteve prej letërës	38,656.39	89,680.54	98,626.44	8,945.90	9.98	408,142.57	420,023.52	387,783.89	(32,239.63)	(7.68)
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-				-	-		
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	20.00		-			520,882.13	353,981.98	388,517.99	34,536.01	9.76
20	Prodhimi i produkteve kimike	164,444.14	293,053.61	2,125,023.41	1,831,969.80	625.13	798,371.46	912,702.40	2,008,042.19	1,095,339.79	120.01

21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	-	540,300.00				2,171,639.95	1,981,112.15	1,784,475.36	(196,636.79)	(9.93)
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	7,498,335.98	10,592,959.00	10,884,862.08	291,903.08	2.76	1,329,700.29	950,653.8	1,962,641.09	1,011,987.29	106.45
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	1,584,746.34	2,136,675.17	3,578,711.16	1,442,035.99	67.49	1,255,337.25	881,333.64	1,095,502.76	214,169.12	24.30
24	Prodhimi i Metaleve	1,434,712.54	1,320,338.20	1,822,666.42	502,328.22	38.05	766,561.06	822,106.27	1,360,596.91	538,490.64	65.50
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike	4,971,062.92	5,705,004.31	8,639,380.62	2,934,376.31	51.44	1,777,431.56	906,513.45	1,369,090.92	462,577.47	51.03
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	603,544.66	439,115.44	717,524.39	278,408.95	63.40	1,718,210.78	2,421,932.54	4,363,064.53	1,941,131.99	80.15
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	1,128,991.17	1,318,182.27	1,756,016.24	437,833.97	33.21	1,061,129.13	1,017,043.46	1,101,156.70	84,113.24	8.27
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	378,588.70	218,351.44	259,835.02	41,483.58	19.00	3,250,076.84	2,614,280.30	2,774,468.14	160,187.84	6.13
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	276,287.72	471,186.08	390,298.40	(80,887.68)	(17.17)	238,394.11	250,053.79	380,193.87	130,140.08	52.04
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	31,353.49	53,274.14	14,520.22	(38,753.92)	(72.74)	248,216.59	406,871.36	309,589.87	(97,281.49)	(23.91)
31	Prodhimi i mobileve	6,337,998.92	8,596,968.62	11,748,506.87	3,151,538.25	36.66	1,033,619.27	836,766.14	999,467.30	162,701.16	19.44
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	207,443.92	158,198.95	381,545.22	223,346.27	141.18	1,160,181.67	828,910.48	2,021,349.01	1,192,438.53	143.86
	Gjithsej	29,174,188.40	38,739,958.50	50,034,418.16	11,294,459.66	29.15	31,611,941.36	24,833,371.57	34,613,291.49	9,779,919.92	39.38

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

- **Eksporti me vendet e EFTA-së**

Nën sektori “Prodhimi i mobileve”, në vitin 2021, në kuadër të Sektorit-C, merr pjesë në eksportet me vendet e EFTA-së me 23.4%. Ndërsa, në kuadër të nën sektorit ka shënuar rritje për 36% krahasuar me vitin 2020. Eksporti i këtyre produkteve më së shumti është realizuar në Zvicër me 98%.

Në vendin e dytë me eksporte, në vendet e EFTA-së, radhitet nën sektori “Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës” me pjesëmarrje prej 21.7%, në kuadër të Sektorit C. Në vitin 2021 ky nën sektor ka shënuar rritje për 3% krahasuar me vitin 2020, produktet e këtij nën sektori, janë eksportuar në Zvicër me 99.6%.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike”, me vendet e EFTA-së, ka pjesëmarrje për 17%. Ky nën sektor në vitin 2021, ka shënuar rritje të eksportit për 51.4% krahasuar me vitin paraprak, produktet e këtij nën sektori kanë shënuar eksportin më të lartë në Zvicër me 91.8%.

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie, prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshetuara thurëse”, radhitet i katërti me pjesëmarrje në eksporte me këto vende për 9%. Në vitin 2021 eksporti ka shënuar rritje për 22% krahasuar me vitin paraprak, produktet nga druri janë eksportuar në Zvicër me 99.8%.

- **Importi me vendet e EFTA-së**

Importet me vendet EFTA-së, dominohen me pjesëmarrje në importet nga nën sektori “Prodhimi i produkteve të duhanit” me 20.9%. Në vitin 2021, ky nën sektor ka shënuar rritje për 47%, krahasuar me vitin 2020. Produktet e duhanit janë importuar nga Zvicra me 100%.

Nën sektori “Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike”, merr pjesë me 12.6% në vendet e EFTA-së. Ndërsa në vitin 2021 ka shënuar rritje për 80% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Zvicra me 55.1%, dhe nga Norvegjia me 44.9%.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.”, merr pjesë në importe me 8%, ndërsa në kuadër të nën sektorit, në vitin 2021, ka shënuar rritje për 6% krahasuar me vitin paraprak. Këto produkte janë importuar nga Zvicra me 98.7%.

Nga 23 nën sektorët 5 prej tyre, pësuan rënie në import me vendet e EFTA-së. Në vitin 2021 më së shumti rënie ka shënuar nën sektori “Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure” me 42%, dhe “Prodhimi i mjeteve tjera të transportit” me 24% krahasuar me vitin paraprak.

2.4. Eksporti dhe Importi me vendet tjera

Eksportet me vendet tjera për vitin 2021, kanë shënuar vlerën prej 163 milion euro, krahasuar me vitin 2020 ka shënuar rritje mbi 100%.

Importet me vendet tjera, për vitin 2021, kanë shënuar vlerën prej 1.528 miliard euro, krahasuar me vitin 2020 ka shënuar rritje për 45.8%. Shkëmbimi tregtar i Kosovës me vendet tjera është 90% e vlerës së importeve dhe 10% eksporte.

Tabela 9. Vlera e Eksporteve dhe Importeve me vendet e tjera për vitin 2019 - 2021

Kod i	Industria Përpunuese, Sektori-C	Eksporti			Bilanci		Importi			Bilanci	
		2019	2020	2021	Ndryshimi (2020 >2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)	2019	2020	2021	Ndryshimi (2020 >2019)	Ndryshimi në % (2020>2019)
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	3,095,757.49	3,460,546.54	3,596,026.20	135,479.66	3.91	124,142,753.55	109,877,274.50	135,974,228.58	26,096,954.08	23.75
11	Prodhimi i pijeve	915,117.63	1,304,206.39	1,227,490.04	(76,716.35)	(5.88)	4,487,749.40	4,115,175.57	8,594,604.98	4,479,429.41	108.85
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	-	-	-			8,307,737.58	9,638,693.32	15,820,303.98	6,181,610.66	64.13
13	Prodhimi i Tekstilit	964,702.52	8,404,960.99	8,877,237.31	472,276.32	5.62	47,639,666.37	56,601,803.78	88,417,420.71	31,815,616.93	56.21
14	Prodhimi i veshjeve	611,746.49	2,425,676.30	6,958,614.29	4,532,937.99	186.87	109,063,354.20	90,815,489.98	131,947,874.72	41,132,384.74	45.29
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkurë	2,154.52	11,137.26	39,836.32	28,699.06	257.69	44,377,194.57	33,693,526.77	44,062,645.36	10,369,118.59	30.77
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës, përveç mobilie; prodhimi i artikujve nga kashta dhe materialeve të gërshtuara-thurëse	83,200.14	51,730.44	470,321.70	418,591.26	809.18	19,740,667.67	17,973,978.18	29,283,934.86	11,309,956.68	62.92
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	18,695.62	25,130.64	41,260.62	16,129.98	64.18	13,557,299.72	12,828,554.40	20,045,788.27	7,217,233.87	56.26
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	-	-	-			144,880.98	118,326.26	30,687.18	(87,639.08)	(74.07)
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	-	-				118,980,181.99	77,375,351.99	143,260,942.76	65,885,590.77	85.15

20	Prodhimi i produkteve kimike	63,696.10	2,480,191.63	247,135.49	(2,233,056.14)	(90.04)	79,677,809.43	82,068,935.29	124,170,222.93	42,101,287.64	51.30
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	335,348.84	108,718.50	242,502.17	133,783.67	123.06	13,685,021.94	23,083,142.88	28,411,464.53	5,328,321.65	23.08
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	3,992,145.28	3,733,068.79	4,721,154.95	988,086.16	26.47	50,759,284.77	50,312,464.07	62,260,412.85	11,947,948.78	23.75
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	575,854.23	264,465.54	1,291,312.59	1,026,847.05	388.27	49,040,451.76	46,463,738.06	67,644,050.21	21,180,312.15	45.58
24	Prodhimi i Metaleve	32,687,755.37	8,145,609.37	5,551,464.58	(2,594,144.79)	(31.85)	69,639,733.00	57,350,124.03	106,340,858.19	48,990,734.16	85.42
25	Prodhimi i produkteve të fabrikuar metalike	1,797,249.86	1,171,122.07	10,604,318.66	9,433,196.59	805.48	49,197,416.83	53,761,361.23	65,793,701.17	12,032,339.94	22.38
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	496,130.70	1,324,344.18	1,450,409.54	126,065.36	9.52	77,910,771.12	80,483,118.00	117,719,355.20	37,236,237.20	46.27
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	73,270.09	63,031.72	193,390.06	130,358.34	206.81	81,073,800.98	82,246,402.42	102,142,969.60	19,896,567.18	24.19
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	1,239,008.87	1,415,249.68	3,183,352.55	1,768,102.87	124.93	99,376,654.00	96,660,637.95	126,091,522.70	29,430,884.75	30.45
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	508,987.63	857,360.65	1,381,501.30	524,140.65	61.13	23,220,491.03	32,809,087.68	34,001,085.67	1,191,997.99	3.63
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	3,500.00	90.00	250.00	160.00	177.78	6,108,233.28	13,332,544.49	50,034,180.76	36,701,636.27	275.28
31	Prodhimi i mobileve	177,191.33	13,713,568.17	113,009,866.23	99,296,298.06	724.07	30,339,203.07	23,346,529.42	38,373,987.81	15,027,458.39	64.37
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	98,239.41	72,381.64	120,855.97	48,474.33	66.97	30,144,471.05	30,189,644.27	42,483,203.47	12,293,559.20	40.72
	Gjithsej	47,739,752.12	49,032,590.50	163,208,300.57	114,175,710.07	232.86	1,150,614,828.29	1,085,145,904.54	1,582,905,446.49	497,759,541.95	45.87

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/D

- **Eksporti me vendet tjera**

Duke u bazuar në të dhënat e paraqitura në tab. nr.12, vërehet se eksportet me vendet tjera, i paraprinë nën sektori “Prodhimi i mobilieve”, dhe “Prodhimi i Tekstilit”, si rezultat i marrëveshjeve tregtare në mes të kompanive vendore me SHBA-të.

Nën sektori “Prodhimi i mobilieve” radhitet i pari me pjesëmarrje në eksporte me vendet e tjera me 69%, me rritje mbi 100% të eksporteve në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak, rritje rreth 100 milion euro. Produktet e mobilieve eksportohen në SHBA me 95%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i produkteve të fabrikuara metalike” me vendet tjera, në kuadër të Sektorit-C merr pjesë në eksporte me 6.5%, ndërsa në vitin 2021 kanë shënuar rritje të theksuar mbi 100% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e prodhuara nga ky nën sektor kryesisht janë eksportuar në Kazakistan për 90%.

Nën sektori “Prodhimi i Tekstilit” radhitet e treta me pjesëmarrje në eksporte me këto vende me 5.5%. Në vitin 2021 ka shënuar rritje mbi 5.6% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e tekstilit janë eksportuar kryesisht në SHBA për 88.7

- **Importi me Vendet tjera**

Në kuadër të Sektorit-C, nën sektori “Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës”, në import merr pjesë me 9%, ndërsa në vitin 2021, ky nën sektor ka shënuar rritje për 85% krahasuar me vitin 2020, këto produkte janë importuar nga Arabia Saudite për 43%, nga Izraeli për 15%, nga Turqia për 14%, etj.

Nën sektori “Përpunimi i produkteve ushqimore”, radhitet i dyti në importe me pjesëmarrje prej 8.5%, në kuadër të Sektorit-C, në vitin 2021. Ky nën sektor ka shënuar rritje të importeve për 23.8 % krahasuar me vitin 2020. Produktet e veshjeve janë importuar nga Turqia për 33%, nga Brazili për 31%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i veshjeve”, merr pjesë në importe me 8.3% dhe me rritje prej 45% në vitin 2021 krahasuar me vitin paraprak. Produktet e veshjeve janë importuar nga Turqia për 57%, nga Kina për 19%, etj.

Nën sektori “Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.”, radhitet i treti me pjesëmarrje në importe me 7.9%, në vitin 2021 dhe ka shënuar rritje për 30% krahasuar me vitin paraprak. Produktet e makinerisë janë importuar nga Kina për 45.4%, nga Turqia për 35.8%, etj.


Ndërsa kur flasim për rënien, nën sektori “Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara” është i vetmi që ka pësuar rënie për 74%.

Diversiteti gjeografik i eksporteve dhe importeve

Sipas të dhënave për eksportin të vitit 2021, tregjet më të synuara për produktet e Kosovës kanë qenë kryesisht në BP6 dhe vendet e BE-së.

Sipas këtyre të dhënave, tregu i Kosovës është kryesisht i diversifikuar në afërsisht 10 vende, që konsiderohen tregje të mëdha.

Figura 7: Pjesëmarrja e prodhimit në tregjet e eksportit në vitin 2021




Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

Sipas të dhënave për importin në vitin 2021, tregjet më të synuara kanë qenë kryesisht në BE dhe vendet Vendet tjera.

Sipas këtyre të dhënave, Importi i Kosoves kryesisht është i nvarur afërsisht nga 9 vende.

Figura 8: Vendet nga importohen produktet prodhuese 2021



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/DI

ANALIZA SOCIALE

Fuqia punëtore

Sipas ligjit të punës në Kosovë, marrëdhënia e punës mund të themelohet me çdo person prej moshës tetëmbëdhjetë (18) vjeçare. Fuqia punëtore përbëhet nga personat e punësuar dhe personat e papunë, ndërsa personat joaktivë nuk konsiderohen pjesë e fuqisë punëtore. Norma e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore është përqindja e popullsisë në moshë pune e një vendi, që angazhohet në mënyrë aktive në tregun e punës.

Kosova përballlet me sfida thelbësore sociale, të manifestuara në varfëri të lartë dhe papunësi, tetëmbëdhjetë përqind (18%) e popullsisë së Kosovës jeton nën kufirin e varfërisë, me 5.1% që jetojnë në varfëri ekstreme (raporti i BB dhe ASK, 2019). Për më tepër, çdo i gjashti kosovar i punësuar konsiderohet i varfër në punë (Rrjeti Evropian i Politikave Sociale, RrEPS, raport, 2019).

Përqindja kombëtare e papunësisë është në një nivel të konsiderueshëm, sipas të dhënave nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për vitin 2022, prej 12.6%, grupet e cënueshme si gratë janë veçanërisht të prekura (me 16.5% të papuna), ndërsa grup moshat e të dy gjinive të rinjeve nga 15-24 vjeç, papunësia është 33%.

Pjesëmarrja e Sektorit-C në punësim të përgjithshëm

Në këtë pjesë të raportit janë analizuar të dhënat që kanë të bëjnë me numrin e ndërmarrjeve dhe numrin e të punësuarve.

Përveç paraqitjes së të dhënave statistikore, analizat tregojnë edhe për trendët e rënies apo ngritjes të punësimit në sektorët e industrisë, jo vetëm në vitin e fundit por edhe për periudhën krahasuese me vitin paraprak si dhe trendët në periudhën tri vjeçare.

Të dhënat krahasuese në tabelën nr.12, tregojnë se, gjatë tri viteve të fundit, është shënuar rritje në punësim dhe në numrin e ndërmarrjeve, që është tregues pozitiv për dy indikatorët e analizuar. të dhënat e analizuara kanë treguar se pjesëmarrja e numrit të përgjithshëm të ndërmarrjeve nga viti 2022, ka shënuar rritje prej 2.97% dhe në numrin e të punësuarve 5.86%, krahasuar me vitin paraprak.

Spektori i prodhimit mund të japë kontribut të rëndësishëm për të zbutur këto sfida duke ofruar mundësi punësimi gjithëpërfshirëse dhe paga më të mira. Megjithatë, sektori i prodhimit ofron mundësi relativisht të kufizuara punësimi, duke punësuar aktualisht rreth 11% të fuqisë punëtore në vitin 2021, nga 13% në vitin 2015.

Spektori C- Industria përpunuese, në normën e punësimit sipas aktivitetit ekonomik merr pjesë rreth 11%.

Tabela 10. Sektori C, numri i ndërmarrjeve dhe të punësuarve

Kodi	Industria Përpunuese	Numri i ndërmarrjeve			Numri i të punësuarve		
	Sektori-C	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022	Viti 2020	Viti 2021	Viti 2022
10	Përpunimi i produkteve ushqimore	1369	1462	1503	8,081	9,902	9,914
11	Prodhimi i pijeve	78	102	102	2,138	2,221	2,195
12	Prodhimi i produkteve të duhanit	2	7	5	26	74	28
13	Prodhimi i tekstilit	176	173	179	802	809	914
14	Prodhimi i veshjeve	325	350	397	1,151	1,610	1,562
15	Prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure	43	39	39	420	406	454
16	Prodhimi i drurit dhe i produkteve të drurit dhe të tapës	477	521	506	1,766	2,389	2,296
17	Prodhimi i letrës dhe produkteve prej letrës	107	102	111	720	646	658
18	Shtypja dhe riprodhimi i mediave të incizuara	177	180	174	785	962	842
19	Prodhimi i Koksit dhe produkteve të rafinuara të naftës	8	8	5	116	179	121
20	Prodhimi i produkteve kimike	114	126	123	762	946	816
21	Prodhimi i produkteve bazë farmaceutike dhe preparateve farmaceutike	7	6	7	103	118	121
22	Prodhimi i produkteve të gomës dhe të plastikës	572	579	626	3,513	3,661	4,260
23	Prodhimi i produkteve minerale jo metalike	511	545	547	5,082	5,469	5,228
24	Prodhimi i Metaleve	121	128	122	1,280	794	1,416
25	Prodhimi i produkteve të fabrikua metalike	736	770	790	3,112	3,065	3,595
26	Prodhimi i kompjuterëve, produkteve elektronike dhe optike	25	28	27	71	80	107
27	Prodhimi i pajisjeve elektrike	33	44	39	224	261	274
28	Prodhimi i makinerisë dhe pajisjeve p.k.t.	33	38	34	174	274	168
29	Prodhimi i mjeteve motorike, rimorkio dhe gjysmë rimorkio	N/A	6	8	53	111	70
30	Prodhimi i mjeteve tjera të transportit	8	9	4	54	55	45
31	Prodhimi i mobileve	514	549	600	3,833	4,915	6,172
32	Prodhimi tjetër p.k.t.	98	106	110	281	430	470
33	Riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve	103	106	104	144	181	149
	Gjithsej	5,637	5,984	6,162	34,691	39,558	41,875

Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/ MINT

Nga të dhënat në tabelën nr.12, sa i përket Sektorit-C, në vitin 2022 kemi rritje të numrit të ndërmarrjeve për rreth 3%, përderisa rritje më e lartë është shënuar për 6.16%, në vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak.


Po ashtu edhe punësimi në vitin 2022, ka shënuar rritje për rreth 5.9%, ndërsa rritje prej 14.03% në punësim është shënuar në vitin 2021, krahasuar me vitin paraprak.

Kontributi i nën sektorëve në punësimin e përgjithshëm të Sektorit-C,

Kontributi i Sektorit të prodhimit/përpunimit në punësimin e përgjithshëm në Kosovë për vitin 2022 është 8.9%.

Punësimi sipas nën sektorëve paraqet kontributin e secilit nën sektor në krijimin e vendeve të punës në kuadër të Sektorit-C, (sektori prodhues/përpunues), i paraqitur si më poshtë:

Figura 9. Kontributi i nën sektorëve në punësimin e Sektorit-C, në % 2022



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës, përpunuar nga DPI/ MINT


Bazuar nga të dhënat e paraqitura në figurën nr 8, kontributin më të lartë në punësim të sektorit prodhues/përpunues në Kosovë, e krijon nën sektori 10-Përpunimi i produkteve ushqimore me rreth 24%, i ndjekur nga nën sektori i 31-Prodhimi i mobilie me rreth 15%, ndërsa i treti me kontribut në punësim radhitet nën sektori i 23-Prodhimi i produkteve minerale jo metalike me rreth 13%.

Gratë të punësuar në Sektorin-C

Kosova kishte shkallën më të ulët të pjesëmarrjes së grave në prodhimtari në vend, duke pas parasysh disa barriera si p.sh mos respektimi i kontratave të punës që karakterizohet ende nga shkalla e lartë e informalitetit dhe kushteve të pa pafavorshme të punës, sidomos punësimit të grave dhe të rinjeve.

Deri tani pjesëmarrja e punësimit të grave sipas të dhënave për vitet 2015-2022, është tejte e ulët sidomos në sektorin e prodhimit, trendi i ngadalshëm i punësimit të grave është përcjell vazhdimisht në vend, por me të dhëna premtuese të rritjes pozitive në punësim sipas gjinisë.

Figura 10: Punësimi gjithëpërfshirës në % (sipas gjinisë), në Kosovë 2015-2022



Burimi: ASK (përpunuar nga DI/DPI-së)

Bazuar në të dhënat e publikuara nga figura nr. 9, vërejm se punësimi i grave në Kosovë në punësimin e përgjithshëm në vitin 2015 ishte 22.5%, ndërsa në vitin 2022 kishte shënuar rritje të lehtë në rreth 27%, që paraqet rritje për 4.5%, ndërsa pjesëmarrja e punësimit të grave në totalin e punësimit në prodhim, ishte i ulët në Kosovë, në vitin 2015 prej 10.22% dhe në vitin 2022 me rritje për rreth 17.5%, që paraqet rritje në favor të punësimit prej 7.3%.

Elasticiteti i punësimit

Ndryshimet globale edhe në tregjet e punës kanë krijuar mundësi të mëdha, që edhe ekonomit e zhvilluar të kenë vështirësi në ruajtjen e elasticitetit të punësimit, ndryshimet mund të vijnë edhe nga faktor të shumtë qoftë nga kriza që mund të jenë të pa parashikuara, siç ishte me pandeminë Covid-19, por edhe si pasojë e transformimit dixhital. Elasticiteti mund të ketë ndryshime në raport me produktivitetin në punë varësisht kah do të jetë e orientuar norma vjetore e rritjes qoftë nga punësimi apo nga produktiviteti.

Tabela 11: Elasticiteti i punësimit krahasuar me vendet tjera

Vendet	Norma vjetore e rritjes së punësimit	Norma vjetore e rritjes së VSHP	EE	Klasifikimi
Shqipëria	4.7%	3.7%	1.29	Drejtuar nga punësimi
Bosnja dhe Hercegovina	2.0%	1.7%	1.18	Drejtuar nga punësimi
Mali i Zi	2.4%	0.6%	3.84	Drejtuar nga punësimi
Maqedonia e Veriut	0.9%	-0.5%	(2.04)	Drejtuar nga rritja e pa punësisë
Serbia	4.9%	1.5%	3.25	Drejtuar nga punësimi
Kosova	2.8%	2.5%	1.11	Drejtuar nga punësimi
BP6	3.7%	1.5%	2.39	Drejtuar nga punësimi

Burimi: WDI, UNIDO, ILO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Analiza tregon se ndërmjet viteve 2015-2020, sektori i prodhimit të Kosovës u rrit çdo vit me një normë të përbërë prej 2.5%, ndërsa punësimi në industri u rrit me 2.8%, gjatë të njëjtës periudhë. Sipas këtyre të dhënave vlerësohet se norma e rritjes në Kosovë është e drejtuar (udhëhequr) nga punësimi. Vështruar në përgjithësi tabelën, del se në shumicën e vendeve të Ballkanit perëndimor e kemi një situatë të njëjtë, rritjet janë të drejtuara nga punësimi.

Nga analizat e bëra ka rezultuar se nën sektorët që janë klasifikuar me rritje në punësim krahas rritjes së vlerës së shtuar brenda Sektorit-C, janë; nën sektori i Prodhimit të Pijeve, me elasticitet pozitiv prej 1.8%, nën sektori i Prodhimit të Tekstilit me elasticitet pozitiv prej 3.15%,

Nën sektori i drurit me elasticitet pozitiv prej 4.7%, nën sektori i letrës me 1.18%, nën sektori i prodhimeve kimike me 7.4%, nën sektori i produkteve farmaceutike me 9.53%, nën sektori i plastikës dhe gomës me 1.06%, nën sektori i produkteve jo minerale me 12%, nën sektori i prodhimeve të fabrikuara metalike me 9.51%.

Pagat në Prodhim

Rritja e produktivitetit të punës përkthehet pozitivisht në rritje të pagave në prodhim. Duke u referuar të dhënave nga tabela 11. norma e rritjes së produktivitetit në Kosovë në vitin 2020 është 1.6% dhe rritje të pagave me 5.6%. Ndërsa të gjitha vendet krahasuese të BP6, norma e rritjes së pagave, ishte pozitive edhe pse nuk kanë shënuar normë negative vjetore së produktivitetit në punë.

Tabela 12: Pagat


Vendet	Norma e rritjes së pagave	Norma e rritjes së produktivitetit
Shqipëria	10.10%	-1.01%
Bosnja dhe Hercegovina	3.81%	-0.30%
Mali i Zi	5.17%	-1.38%
Maqedonia e Veriut	9.54%	-3.26%
Serbia	11.10%	-0.28%
Kosova	5.65%	1.57%

Burimi: WDI, UNIDO, ASK (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti relativ i pagave në industrializim

Ndërmjet viteve 2015 dhe 2020, pagat e sektorit të prodhimit u rritën mesatarisht me 11%. Rritja e fitimeve për punëtorët konfirmohet edhe nga studimi i intensitetit relativ të pagës, i matur si përqindje e pagave të prodhimit si pjesë e VShP. Ky tregues mat pjesën e VShP-së që u shkon punëtorëve të sektorit të prodhimit në formë të pagave. Figura 7 më poshtë tregon se intensiteti relativ i pagave në Kosovë është rritur nga 21% (2015) në 35% (2020). Shkurtimisht, me një sektor prodhimi në rritje, fatura totale e pagave të prodhimit është rritur. Megjithatë, ajo rezulton ende në intensitetin më të ulët të pagave relative në rajon. Të gjitha vendet krahasuese zënë mbi 40% të peshës së pagave në VShP.

Figura 11. Intensiteti relativ i pagave të industrisë




Burimi: Indikatorët e Shteteve

Totali i pagave në Sektorin-C, në raport me Vlerën e shtuar në prodhim (VSHP)

Paraqet raportin në mes faturës së kostos totale të pagave për Sektorin-C, në korrelacion me vlerën e shtuar të prodhimit.

Në figuren 10, më poshtë janë paraqitur disa nga nën sektorët e Sektorit-C, ku shihet raporti në përqindje i VSHP-së me faturën e pagës totale për nën sektor.

Figura 12: Fatura e pagave në raport me vlerën e shtuar, VSHP shprehur në %



Burimi: Agjencia e Statistikave të Kosovës (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)


ANALIZA MJEDISORE

Eficienca e energjisë në sektorin e prodhimit

Kosova në vitin 2021, vlerën e eficientes së energjisë në prodhim e kishte 3.13 milion euro për njësi të ktoe (kilo ton për njësi ekuivalente të naftës), është me pak se mesatarja e vendeve të BP6 me 3.20 milion euro/ktoe. Vlerën më të lart të eficientes së energjisë e kishte BEH me 3.97 milion euro/ktoe, ndersa vlerën më të ulët ka Mali i Zi dhe kishte vlerën më të ulët prej 1.38 milion euro/ ktoe.

Në vitin 2013 efienca e energjisë ishte 2.61 milion euro/ njësi e ktoe, në vitin 2021 kemi rritje të eficientes per 20%, në vlerën 3.13 milion euro për njësi të ktoe.

Figura 13: Eficienca e energjisë në sektorin e prodhimit




Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti i energjisë në prodhim

Intensiteti energjetik në Kosovë (sasia e energjisë së përdorur për të prodhuar një njësi të BPV), është përmirësuar ndjeshëm me kalimin e kohës, nga viti 2013 në vitin 2021 kemi rënie të inetzitetit të energjisë për 12.28%, mire po është më i lartë se mesatarja e vendeve të Ballkanit perëndimor.

Figura 14: Intensiteti i energjisë




Burimi: International Energy Agency (IEA)

Emetimet e CO2

Emetimet e CO2 të Kosovës në sektorin e prodhimit janë (1.1 ton CO2 për 1 milion EUR në VSHP), nga viti 2013 në vitin 2020 ka rënje për 31.5% edhe pse ka rënie prap është mbi mesataren e BP6. Emetim më të ulët ka Bosna dhe Hercegovina prej 0.44 kton CO2 dhe Serbia me 0.48 kton CO2 për 1 milion euro VSHP, ndërsa për Malin e Zi nuk ka të dhëna për emetimin e CO2.

Figura 15: Emetimet e CO2, për 1 milion euro në Vlerën e Shtuar të Prodhimit




Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Intensiteti i CO2 për vlerën e shtuar në Prodhim

Kosova e zvogëloi intensitetin e saj të CO2 për 1 milion euro të VShP, me një normë të ngjashme vjetore me vendet e tjera të BP6, por me Bosnjën dhe Serbinë që i reduktuan ato me një ritëm pak më të shpejtë, ndërsa në vitin 2020 intensitetin e emetimit të CO2 e ka më të lartë se sa Serbia, Maqedonia e Veriut dhe BeH, dhe më të ulët se sa Mali i Zi dhe Shqipëria.

Figura 16: Intensiteti i CO2 për €1 milion të VShP të gjeneruar



Burimi: International Energy Agency (IEA) (përpunuar nga stafi i DI/DPI-së)

Konkluzionet

- Kosova edhe pse ka treguar rritje të BPV-së për koke banori dhe është rritur me një rritje më të shpejtë se vendet e rajonit ende është nën mesataren e BP6,
- Sektori i prodhimit, mbetet i qëndrueshëm në pjesëmarrje në BPV, me gjithatë krahasuar me vitin 2021 ka treguar rënie dhe vazhdon të mbajë vendin e dytë pas tregtisë edhe pse kontribon në rritjen e vlerës së shtuar të prodhimit në vend si dhe në rritjen e numrit të punësuarve,
- Industrializimi i Kosovës, i matur me pjesëmarrjen e VSHP-së në BPV, tregon një qendrueshmëri ndër vite dhe është më i lartë se Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut,
- Struktura e përzierjes ekonomike të Kosovës, bazuar në pjesëmarrjen e VShP-së në BPV, vazhdon të dominohet nga sektori i shërbimeve, me një mesatare prej 45%, ndërsa sektori i prodhimit merr pjesë me një mesatare prej 13% të VSHP në BPV,
- Investimet e huaja direkte ndikojnë në rritjen Ekonomike, me gjithatë IHD janë të orientuara në sektorin e patundshëmve dhe ndërtimit të cilat kanë më pak efekt të përhapjes/shtrirjes (spillover effect),
- Normat e interesit bankar janë ende të larta për industrinë përpunuese me 6%, gjë që u pamundësojnë bizneseve zgjerimin e kapaciteteve të tyre në prodhim,
- Industria prodhuese/përpunuese ka potencial të lartë në uljen e deficitit tregtar, duke marrë parasysh pjesëmarrjen në eksportin e përgjithshëm me 83%, ku mbulueshmëria e importit me eksport është me vetëm 14%.
- Eksportet e produkteve të industrisë prodhuese/përpunuese janë nga vendet ku është e përqendruar diaspora, gjë që e pasqyron diversifikimin e kufizuar të eksporteve në tregun e përgjithshëm. Rëndësia e diversifikimit vërehet me zgjerimin e eksporteve me SHBA, në rastin konkret në industrinë e nën sektorit “Prodhimi i mobileve”,
- Importet e industrisë përpunuese vazhdojnë të jenë të larta, për arsye se ekonomia e Kosovës nuk po arrin të intensifikojë sigurimin e lëndëve të para nga burimet vendore që do të kontribonin në uljen e importit,
- Sektori i industrisë përpunuese ka potencial për punësim më të lartë të grave, por pjesëmarrja e grave në punësim në ky sektor vazhdon të jetë e ulët, në krahasim me vendet e BP6,
- Vlerësuar produktivitetin dhe pagat, Kosova dhe vendet tjera të BP6, kanë rritje në paga, megjithatë Kosova ka shënuar rritje në normën e produktivitetit, ndërsa vendet tjera kanë normë negative në produktivitet,

- Eficienca e energjisë në industrin prodhuese/perpunuese në Kosovë vazhdon të ketë rritje nderë vite, mirpo qendron nën mesataren e vendeve të BP6 dhe më mirë se Shqiperia dhe Mali i Zi.
- Emetimet e CO2 në industrin prodhuese/perpunuese në Kosovë vazhdon të ketë renie nderë vite, mirpo qendron mbi mesataren e vendeve të BP6 dhe ka me pak emitim të CO2 se Shqiperia dhe Maqedonia e Veriut.

Referencat

- Agjencia e Statistikave të Kosovës / Anketa e Fuqisë Punëtore
- Agjencia e Statistikave të Kosovës, Vjetari Statistikor
- Banka Qendrore e Kosovës, Raporti vjetor 2022
- Banka Qendrore e Kosovës, IHD sektoreve ekonomik, [https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur më 05.07.2023](https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur_më_05.07.2023)
- Banka Qendrore e Kosovës, IHD sipas vendeve, [https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur më 29.06.2023](https://bqk-kos.org/statistikat/serite-kohore/qasur_më_29.06.2023)
- Exports by enterprise size class - OECD iLibrary, https://www.oecd-ilibrary.org/docserver/entrepreneur_aag-2013-11-en.pdf
- International Energy Agency (IEA)
- United Nations Industrial Development Organization (UNIDO), <https://www.unido.org/search?keys=wages+kosovo>
- World Development Indicators (WDI), <https://databank.worldbank.org/source/world-development-indicators>
- World Integrated Trade Solution (WITS), <https://wits.worldbank.org/>

Ky raport është përgatitur nga Departamenti i Industrisë/**Divizioni për Politika Industriale**.

Falënderojmë **Agjencinë e Statistikave të Kosovës** për bashkëpunimin e treguar për ofrimin e të dhënave statistikore.

Kontakti:

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Departamenti i Industrisë, Divizioni për Politika Industriale

Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, Lagja e Spitalit

10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +383 38 200 36 547

<http://www.mint-rks.org>